

THIRRJE PËR TENDER

(Blerje Ekografi Gjinekologjike)

Të nderuar,

Përmes këtij njoftimi ju ftojmë të paraqesni ofertat që disponon kompania juaj lidhur me pajisjen e një ekografie gjinekologjike të levizshme që do të shërbejë Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZH) në realizimin e vizitave dhe ekzaminimeve gjinekologjike në klinikën e saj në Tiranë.

Informacion i përgjithshëm rreth QShPZH

QShPZH-ja është një organizatë jo fitimprurëse, e themeluar në Janar të vitit 1993, e cila punon për përmirësimin e politikave, legjislacionit, të drejtën për informacion dhe shërbime për çështje që shqetësojnë popullatën dhe zhvillimin e saj, përfshirë shëndetin riprodhues.

QSHPHZ ofron shërbime risi, të cilësisë së lartë, të orientuara nga nevojat e grupeve përfituese, duke synuar akses në rritje për ta. QSHPHZ-ja, gjithashtu, ofron një mundësi për dialog, rrjetëzim dhe bashkëpunimin ndërmjet përfituesve dhe partnerëve në nivel rajonal, kombëtar dhe lokal.

Momentalisht organizata ka tre qendra multifunksionale si qendra “AULONA” në Vlorë (1998), qendra “PO” në Tiranë (2000) dhe qendra “TROKITJA” në Shkodër (2001).

Gjatë 10 viteve të fundit, QSHPHZ ka mundësuar 70,000 shërbime të shëndetit riprodhues (SHSHR), këshillime ligjore dhe psiko-sociale për të rinjtë dhe gratë ne nevojë duke përfshirë: parandalimin e kancerit të qafës së mitrës (pap test, këshillime dhe trajtime të dëmtimeve pre-kanceroze me krioterapi), eko, këshillime për infeksionet seksualisht të transmetueshme, testin e shpejtë të HIV-it, kujdesin para dhe pas abortit, kujdesin për nënat e reja para dhe pas lindjes dhe këshillimin mbi marrëdhëniet nëpërmjet dy klinikave në Tiranë dhe Vlorë dhe shërbimeve me bazë në komunitet, si dhe klinikave të lëvizshme.

TERMA REFERENCE

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin ofron shërbime të Shëndetit Rirpdohues dhe Seksual për gratë dhe vajzat të moshës 15 – 65 dhe veçanërisht grupeve vulnerabël përmes klinikave të saj mjekësore: Qendra Aulona (Vlorë) dhe Qendra PO (Tiranë).

Për ofrimin e shërbimeve QSHPZH-së i nevojitet një ekografi gjinekologjike e levizshme me qëllim realizimin e shërbimeve të tilla si ekografi abdominale dhe ekografi vaginale të cilat do të ofrohen si në klinikë ashtu edhe në komunitet në bsahkëpunim me Qendrat Shëndetësore të zonave rurale të Tiranës.

Objekti

- Blerja e një ekografie gjinekologjike të levizshme:

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia e parashikuar	Çmimi me TVSH /njësi (ALL)	Vlera me TVSH (ALL)
1	Ekografi gjinekologjike e lëvizshme	copë	1	3,000,000 ALL	3,000,000 ALL

2. SPECIFIKAT E PAJISJES

X3 Portable Color Doppler System

128 element convex array 3C-A (Abdominal, Obstetrics, Gynecology), 1.0-7.0 MHz/R50mm,
128 element andocavity 6V1 (Gynecology, Obstetrics, Urology), 3.0-15.0 MHz/R11mm,
BLACK and WHITE PRINTER P95DE.

3. DATA DHE VENDI

Me kërkesë të organizatës (QShPZh), ofertat për pajisjen ekografi gjinekologjike do të dorëzohen në Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin

Adresa: Bulevardi “Gjegj Fishta”, Nd.26, H.6, Ap.5, 1001, Tiranë.

Tel: +042251475, brenda datës 30.11.2020, ora 16:30.

4. Përzgjedhja dhe Tarifat

Operatori ekonomik i cili do të përzgjidhet për ofrimin e shërbimit të lartë përmendur, do ti kryhet pagesa pas dorëzimit të pajisjes (ekografi gjinekologjike) dhe faturës përkatëse në llogarinë bankare të subjektit.

5. Aplikimi

Ju ftojmë të shprehni interesin tuaj duke dërguar aplikimet tuaja me postë ose dorazi në adresën (adresa: Bulevardi “Gjegj Fishta”, Nd.26, H.6, Ap.5, 1001, Tiranë).

Dokumentat e aplikantit si më poshtë:

- NIPT, Ekstrakt historik
- Statusi në gjykatë që nuk është në proces gjyqësor,
- Oferta Financiare përfshirë TVSH për pajisjen që kërkohet.

6. Vlerësimi i ofertave:

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për ofertën më të ulët financiare.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh), inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.

Për çdo pyetje, ju lutem mos ngurroni ti adresoni në adresën e email: info@acpd.org.al



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT